



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 63/2012
Prishtinë, më 8.05.2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të ftuar: Mimoza Kusari – Lila, zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë; Halit Gara, kryesues i Bordit të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave;

Pjesëmarrës të tjerë: Arta Istrefi dhe Avdi Smajlaj-MTI; Ukë Gashi ZPRK; Bajram Gecaj –US Embassy; Burim Ejupi dhe Dita Dobranja - INDEP; Elizabeta Gjidota -KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e 2 dhe 4.05.2012;
3. Raportim i ministres së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit 2011, më theks të veçantë në fushën e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2011;
5. Shqyrtimi i Listës së Rentave Minerare;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Propozoi që të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës, si; Shqyrtimi i Propozim – Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për energji, sepse kemi një propozim të ri.

Pas debatit me 4(katër) vota Për dhe 3(tri) Kundër Komisioni miratoi propozimin e kryetarit.

2 .Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 2 dhe 4.05.2012

Procesverbalet nga mbledhjet e 2 dhe 4.05.2012 u miratuan pa vërejtje.

3. Raportim i ministres së Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit 2011, më theks të veçantë në fushën e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës;

Kryetari – Theksoi se, ashtu siç është paraparë në këtë pikë të rendit të ditës, do të raportoi, znj. Mimoza Kusari – Lila, zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë, e cila do të paraqesë një ekspozë lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit 2011, më theks të veçantë në fushën e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Ai në vijim tha se në kuadër të punës së Komisionit, takimet me ministrinë përkatëse janë në agjendën e punës së përhershme të Komisionit, ndërsa përmbushjen e obligimeve të dala nga Raporti i Progresit i vlerësoi të rëndësishme të veçantë, dhe pastaj do të hapim debat në lidhje me këtë çështje.

Mimoza Kusari – Lila, (zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë) – I njoftoi deputetët për hapat e deritashëm që ka marrë ministria për përmbushjen e detyrimeve të dala nga Raporti i Progresit, për të cilat tha se ato janë arritur në masën më të madhe dhe është duke u punuar në përmbushjen e tyre në tërësi. Ministria, znj. Kusari–Lila në mënyrë kronologjike paraqiti hapat që ka marrë Ministria, duke filluar me Planin e Veprimave për reformat e të bërit biznes dhe caktimin e prioritetëve, krijimin e politikave të përshtatshme për zhvillim të qëndrueshëm afarist, krijimin e mjedisit të favorshëm ligjor dhe nxitjen e investitorëve për mundësinë e zhvillimit të biznesit. Ministria Lila fillimisht foli për zbatimin e legjislacionit në fushën e konkurrencës, për të cilin tha se monitorimi i kësaj pakoje të ligjeve nuk është pjesë e kompetencave të MTI- së. Lidhur me këtë ajo iu referua Ligjit të konkurrencës për të cilin tha: "Zbatimi i Ligjit të konkurrencës bëhet nga Komisioni i Konkurrencës që është institucion i themeluar nga Kuvendi i Kosovës". Në vijim, ajo foli për Agjencinë e Standardizimit dhe numrin e përgjithshëm të standardeve të adaptuara nga kjo agjenci. Në vijim, ministria Lila foli edhe për Departamentin e Metrologjisë, për të cilin tha se është në fazën e ristrukturimit. Lidhur me këtë, ajo po ashtu njoftoi se Laboratori Qendror i Metrologjisë së Kosovës ka të funksionalizuar Laboratorin e masës, madhësi elektrike, vëllimit dhe rrjedhjes, Laboratorin për kontroll të cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara, ndërsa Laboratori i forcës së termometrisë posedon të gjitha pajisjet dhe është në fazën e certifikimit. Duke folur për Inspektoratin e tregut në MTI, Lila tha: "Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit, MTI-ja është duke dialoguar me komunat për të futur nën ombrellën e Inspektoratit të tregut të gjithë inspektorët komunal". Në vijim ajo njoftoi edhe për masat e marra nga MTI-ja për mbrojtjen e konsumatorëve, përafrimin me standardet evropiane dhe njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale. Ndër çështjet më me rëndësi, sipas ministres Lila, janë politikat tregtare, të cilave u kushtoi rëndësi të veçantë në paraqitjen e saj para Komisionit. Duke iu referuar punës së

deritashme dhe përpjekjeve të MTI-së që të kenë rezultate sa më të mira në këtë fushë. Ministria me këtë rast tha: "Institucionet e Kosovës kanë dëshmuar që kanë kapacitete të udhëheqin mekanizmat rajonal të tregtisë së lirë, siç është CEFTA". Ajo me këtë rast përkujtoi se gjatë vitit 2011, Kosova ka udhëhequr marrëveshjen për tregti të lirë të vendeve të Evropës Juglindore. Në vijim, ministria foli edhe për masat preferenciale me Bashkimin Evropian e që janë votuar nga Parlamenti Evropian në tetor, ndërsa nga Këshilli i Ministrave të BE-së në nëntorin e vitit të kaluar. Në vijim, ajo, tha se efektet retroaktive për Kosovën nga marrëveshja preferenciale me BE-në do të jenë nga një janari, ndërkaq shtoi: "Kjo marrëveshje shpreh qartë qëndrimin e BE-së për progresin e shënuar në përmirësimin e politikave dhe raporteve tregtare në mes Kosovës dhe BE-së"

Kryetari – E pyeti për monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës që i ka bërë Komisioni, lidhur me udhëzimet administrative gjatë monitorimit në është thënë nga zyra ligjore e Qeverisë se nxjerrja e udhëzimeve administrative është kompetencë e MTI-së, sipas ligjit kompetencë e cilit institucion është nxjerrja e udhëzimeve administrative për Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës?

Mimoza Kusari – Lila, (zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë) - Tha në fakt MTI-ja është bartëse e legjislacionit sekondar edhe pse MTI-ja ka sponsoruar Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, por në mënyrë direkte për zbatimin e këtij ligji është përgjegjëse dhe ka kompetenca Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ndërsa MTI-ja është përgjegjëse për rregullimin e ofrimit të kushteve të tregut më anën e Ligjit për masat anti-damping.

Myzejene Selmani – I ngriti disa çështje siç ishin për: Ligjet nga MTI-ja dhe kërkoi që të jenë të cilësisë më të mirë, në mënyrë që funksionimi i tyre të jetë sa më i zbatueshëm. Pyeti se sa po gjen zbatim politika tregtare, Ligji për tregtinë e brendshme, Ligji për shoqëritë tregtare, të cilat janë miratuar nga Kuvendi dhe tani janë përgjegjësi e MTI-së? Për draftimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve pyeti se a do të rritet numri i inspektoreve për mbikëqyrje me të madh të tregut?

Mimoza Kusari – Lila, (zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë) - Tha që sa i për këtë zbatim të politikave tregtare, kemi sfida, por MTI-ja në vazhdimësi është duke punuar dhe me institucionet komunale, ku kanë një pjesë të përgjegjësisë dhe kompetencave për zbatimin e ligjeve në aspektin e politikave tregtare më aprovimin e këtyre ligjeve që ishin për plotësime ndryshim, MTI-ja i ka lehtësuar dhe shkurtuar procedurat e të bërit biznese për biznesit e vendit, ku ka filluar dhe pilot projekte nëpër komuna për hapjen e zyrave për regjistrimin bizneseve, ku do të shkurtohet koha për 3 ditë për regjistrimin e një biznesi. Andaj që këto ditë pritet edhe nënshkrimi i marrëveshjes për tregti të lirë me Turqinë.

Teuta Sahatqija – E pyeti se cili është efekti i fusnotës në përfaqësimin në takimet që i ka MTI-ja, a kanë pasur ndonjë pengesë gjatë takimeve rajonale, ku ka qenë dhe shteti i Serbisë? Për procedurat e çregjistrimit të bizneseve, që nuk janë aktive, a është duke i shkurtuar në kohë procedura për mbylljen e një biznesi i cili ka njoftuar që më nuk është aktiv? Për doing biznesin se sa po funksionon? Për numrin e inspektoreve se a ka MTI-ja numër të mjaftueshëm të inspektoreve për zbatimin e ligjit të komunikimeve elektronike?

Mimoza Kusari – Lila, (zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë) - Për fusnotën tha që nuk ka pasur deri më tani efekte negative në takimet dhe konferencat që kemi marrë pjesë të nivelit politike, nuk është paraqitur ndonjë problem me përfaqësimin tonë si shtet i Republikës së Kosovës, pos në një takim të nivelit teknik. Për pastrimin e listave të bizneseve që nuk janë aktive tha që kjo çështje nuk varët vetëm prej Agjencisë të Regjistrimit të Bizneseve që është në kuadër të MTI-së, por varet dhe nga Administrata Tatimore që është në kuadër të

Ministrisë së Financave. Që të dy ministritë jemi duke i shikuar mënyrën e procedurave për mbylljen e bizneseve të cilat nuk janë aktive. Për doing biznesin tha që kemi të bëjmë me zbatimin e kontratave, është çështje e procedimit të lendeve nëpër gjykata, për lejet e ndërtimeve, kjo është kompetence e komunave. Për kapacitetet e MTI-së në numrin e inspektorëve për ligjin komunikimeve elektronike tha që për këtë ligj MTI-ja shumë pak, gjatë konsultimeve, kemi ardhur në përfundim se MTI-së i duhen dhe një numër më i madh i inspektorëve për zbatimin më të mirë të ligjeve.

Sala Berisha- Shala - Pyeti për inspektoratin e tregut të MTI-së; a janë futur dhe a ka pasur hezitim nga inspektorët e komunave që të futen nën ombrellën e MTI-së? Për mbrojtjen e konsumatorëve së cilat janë fushata vetëdijesimit që ka marrë MTI-ja? Për CEFTA-n, së cilat kanë qenë pengesat në procesin e zhvillimit të tregtisë lirë?

Mimoza Kusari – Lila, (zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë) - Për çështjen e bashkëpunimit të inspektoratit të MTI-së dhe komunave tha që më tepër ka problem të natyrave teknike lidhur me çështjen e funksionimit të zyrave, dhe ka filluar bashkëpunimi i mirë me inspektorate të komunave. Për fushatën e vetëdijesimit për mbrojtjen e konsumatorëve tha që ka pasur 4 tryeza për modalitetet vetëdijesimit të konsumatorëve për produktet që i konsumojnë, po ashtu që në kuder të MTI-së është zyra për ankesa për mbrojtjen e konsumatorëve dhe janë të publikuar të gjitha raporte nga fushatës e vetëdijesimit në ëeb-in e MTI-së. Ndërsa lidhur me CEFTA-n tha që ka pengesë për eksportin e mallrave nga Kosova në drejtim të Serbisë, por siç dihet këto janë problem të natyrës politike.

Ramiz Kelmendi - Ngriti disa çështje rreth mundësisë së zvogëlimit të TVSH- së në dogana për prodhuesit vendor të lëndës së parë, pastaj që MTI-ja që ta zvogëlojë biznesin informale dhe që Qeveria më buxhetin e saj të mos investojë në ngritjen e Zonave Industriale, sepse për këto zona ekonomike, duhet të investojnë vetë investitorët, për kompanitë që privatizojnë ndërmarrjet e sektorit publike duhet të japin efekte në zhvillimin ekonomik dhe në zvogëlimin e papunësisë.

Hashim Deshishku - Pyeti për cilësinë e naftës, se pse MTI-ja ka disa laborator për kontrollimin e naftës, por prapëseprapë po kemi cilësi të dobët të naftës? Pse MTI-ja ende nuk ka ndonjë marrëveshje për lejimin e naftës për ngrohje qendrore? Për zonën Ekonomike në Drenas pse është obliguar që të lidhë kontakt për qira me investitorët për kohë të gjatë?

Mimoza Kusari – Lila, (zëvendëskryeministre dhe ministre e Tregtisë dhe Industrisë) - Për përkrahjen e prodhuesve vendorë në zvogëlimin e TVSH-së në lenden e partë tha që kjo çështje është më tepër është e politikave fiskale të MF-it. Për cilësinë e naftës tha që e kemi bërë 5 trupa inspektuese të kontrollimit të cilësisë të naftës, por ka pasur problem në proces dhe për këtë çështje tani MTI-ja ka nxjerrë udhëzim administrativ dhe janë rregulluar këto probleme me koordinimin e procesit të punës në trupat inspektuese, për naftën djegëse për ngrohje dhe bujqësinë tha jemi duke punuar një udhëzim administrativ, që do të bënte regjistrimin për nevojat e për ngrohje dhe bujqësi. Pastaj të lejohet sasia e naftës për sa është nevojshme për shpenzimet e këtyre nevojave. Në zonën ekonomike industriale në Drenas, tha që qiraja është simbolike dhe është kontratë pak ma e gjatë në mënyrë që të mbulohen shpenzimet për mirëmbajtje të menaxhimit të kësaj zone.

Pas debatit të gjerë, Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

Komisioni do të vazhdojë me agjendën për Integritet Evropian duke përmbushur detyrimet që ka në Planin e Veprimit të Kuvendit

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2011

Kryetari – Theksoi se, ashtu siç është paraparë në këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2011. Ne kemi ftuar përfaqësuesin e Autoritetit Rregullator të Hekurudhave -ARH, z. Halit Gara, i cili do të paraqesë një ekspozitë të shkurtër për këtë Raport në Komision dhe pastaj do të hapim debat në lidhje me këtë çështje.

Halit Gara (Autoriteti i Rregullator të Hekurudhave - ARH) - Theksoi që në fillim se misioni i ARH-së është “Ta mbajmë nivelin më të lartë të standardeve të sigurisë së Hekurudhave”. Kështu që ARH-ja i ka vënë vetes mision që të mbajë sa më lart nivelin e standardeve të sigurisë në Kosovë në fushën e Rregullimit të Hekurudhave, duke pasur vizion që të ofrojë sistemin më të mirë të mundshëm Rregullator të Hekurudhave. Në vijim, ai njoftoi edhe për vështirësitë dhe problemet më të cilat po ballafaqohet ky autoritet, në mungesë të stafit profesional që kanë në sektorin e Hekurudhave.

Kryetari – E pyeti për rritjen e aksidenteve së çka ka ndërmarr Autoriteti Rregullator i Hekurudhave për evitimin e këtyre aksidenteve? Për çështjen e licencave a është duke u respektuar Ligji i aprovuar nga Kuvendi për hekurudhat e Kosovës?

Halit Gara (Autoriteti i Rregullator të Hekurudhave - ARH) – Për çështjen e aksidenteve tha që janë duke punuar dhe bashkëpunuar më stafin profesionist edhe më zyrën e aksidenteve që është në kudër të Qeverisë, për evitimin e aksidenteve të mundshme. Për licencat tha që deri më tani ende nuk kanë dhënë, për arsye që nuk kanë pasur kërkesa, por kjo çështje është e përcaktuar më Ligj që të nxjerrët një rregullore për ndarjen e licencave.

Myzeje Selmani - Tha që ky Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2011, është shumë më përmbajtësor dhe shumë më mirë se i vitit të kaluar, por kërkoj nga përfaqësuesi i ARH-së që të jenë shumë më të angazhuar rreth parandalimit të aksidenteve që të bashkëpunojnë më komunat përkatëse ku kalojnë hekurudhat, dhe organet e rendit që të mos ketë kqyje ilegale dhe të mos shkaktohen aksidente nëpër hekurudhat e Kosovës.

Hashim Deshishku - Tha që Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2011, nuk është përshkruar gjendja e hekurudhave që shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës, siç janë: linjat e hekurudhave për Leposaviq – Mitrovicë, pastaj Prishtinë - Podujevë, në këtë raport nuk është paraqitur gjendja e tyre ekzistuese, po ashtu në raporte nuk janë cekur detajet për vjedhjet që po ndodhin nëpër hekurudhat e Kosovës. Pyeti: pse nuk ka pasur krahasim të shfrytëzimit të transportit më vitin e kaluar se sa është shfrytëzuar transporti i hekurudhave dhe pse nuk ka zëvendës- makinist në trena?

Halit Gara (Autoriteti i Rregullator të Hekurudhave - ARH)- Për çështjen e aksidenteve, tha që ekzistojnë kutit e zeza brenda trenave për të verifikuar së si ka ardhur deri të aksidentet dhe për t'i verifikuar shkaktohet e aksidenteve. Për mos krahasimin raportit të kaluar lidhur me transportin e hekurudhave më Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2011 u pajtua që është bërë një lëshim jo i qëllimshëm, sepse tha kemi menduar mos po rendojmë shumë raportin më detaje. Për linjën e hekurudhave që kalojnë për Leposaviq, tha që këto nuk kanë mundur të kenë qasje për shkak të problemeve politike që dihen që janë në atë pjesë të territorit të vendit, ndërsa për linjën për Podujevë, tha që kjo linjë deri tani nuk është funksionale, dhe këtu po ndodhin vjedhje dhe dëmtim të linjës së trenit.

Pas debatit të gjerë, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2011 të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave.

Kuvendit ia paraqiti këtë

Rekomandim

Të miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2011 të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave.

5. Shqyrtimi i Listës së Rentave Minerare

Kryetari – Theksoi se Lista për Renta Minerare është shqyrtuar në Komision dhe kemi organizuar seancë dëgjimore më të gjitha palët e interesit sipas ligjit. Ishte vendosur që të pritët dhe një kohë për vërejtje dhe sugjerimet e mundshme më shkrim. Mirëpo deri tani nuk ka pasur ndonjë propozim më shkrim nga asnjë palë prezentë që ishin të ftuar në seancën dëgjimore. Andaj, tani në bazë të rregullores së punës, duhet t’ia procedojmë për shqyrtim në seancën plenare në Kuvend.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit dhe Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet “Lista për Rentat Minerare” e propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kuvendit ia paraqiti këtë

Rekomandim

Të miratohet “Lista për Rentat Minerare” e propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji”

Kryetari - I njoftoi deputetët që “Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji” duhet të përshpejtohet për shkak të vakumit që sa kohë është në ZRRE dhe njoftoi se kemi ndryshim në pikën e parë të Vendimit, sepse tani ne vend të kandidatit Ahmet Latifi, kemi kandidaten Merita Kostari.

Hashim Deshishku – Kërkoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, për arsye që më vonesë e kanë marrë materialin për shqyrtimin e Propozim – Vendimit të Qeverisë, për emërimin e anëtarëve të Bordit të ZRRE-së

Myzejene Selmani – Kërkoi mirëkuptim që të përshpejtohet kjo pikë rendit të ditës, për arsye të mos kompletimit të Bordit të ZRRE-së, sepse kanë mbetur shumë projektet pa u realizuar që janë nga KEK-u; KOSTT-i dhe vetë ZRRE-ja.

Sala Berisha – Shala - Po ashtu kërkoi që të procedohet për shqyrtim të mëtutjeshme për seancë plenare ky Propozim-Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për arsyet që i cekën më lart nga kolegët për funksionimin të Bordit të ZRRE-së, për marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me rregullatorin energjisë.

Biserka Kostiq - Kërkoj që në bordet e agjencive, ashtu siç janë pajtuar dhe është rregulluar me Ligj, që të ketë të propozuar për anëtarë dhe nga minoritetet e tjera etnike, dhe Qeveria në këto raste duhet jetë transparente se a kanë konkurruar dhe anëtarë nga minoritetet e tjera etnike, që të përfshihen dhe jenë pjese e agjencive dhe bordeve për ta dhënë kontributin e tyre.

Teuta Sahatqija – Tregoi pse herën e kaluar nuk kemi votuar është sepse, kemi të bëjmë me konflikte të interesit dhe ky është kandidati i parë dhe i cili nuk ka ndryshuar. Kërkoj që edhe një herë të analizohet ky Propozim- Vendim i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, sepse kemi të bëjmë me një sektor të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të energjisë.

Kryetari - Theksoi që është konsultuar dhe me zyrën ligjore të Qeverisë dhe i është thënë që propozimet për emërimin e anëtarëve të Bordit të ZRRE-së janë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe ligjin për konflikt të interesit, andaj ne, si Komisioni Funkcional, duhet t'i procedojmë për seance plenare në Kuvend.

Komisioni, pas debatit me 6 (gjashtë) vota Për dhe 3 (tri) kundër nxori këtë

Përfundim

Miratohet Propozim-Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 03/73 datë 07.05.2012 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 10/60 të datës 08.02.2012, lidhur me të propozuarit për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, z. Krenar Bujupi dhe znj. Merita Kostari dhe, për kryesues z. Enver Halimi.

Kuvendit ia paraqiti këtë

Rekomandim

Të miratohet Propozim-Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 03/73 datë 7.05.2012 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 10/60 të datës 8.02.2012 lidhur me të propozuarit për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, z. Krenar Bujupi dhe znj. Merita Kostari dhe, për kryesues z. Enver Halimi.

7. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit